

Deklaratë e përbashkët e Organizatave Mjedisore Forumi për Ndotjes në Shqipëri

Ne, **përfaqësuesit e 50** Organizatave të Shoqërisë Civile, institucioneve akademike-kërkimore që kontribuojnë në adresimin e çështjes së ndotjes në ajër-ujë-tokë, të mbledhura më 20 Prill 2023, në Tiranë në **“Forum për Ndotjen 2023”**, diskutuam mbi statusin e ndotjes, gjurmimin dhe masat që aktualisht aplikohen për minimizimin e saj në vendin tonë. Gjithashtu, në këtë dokument pasqyrojmë jo vetëm perceptimin por edhe fakte lidhur me rezultate të ekspertizave monitoruese sikundër edhe shkallën e përgatitjes së autoriteteve qendrore dhe atyre lokale në adresimin e ndotjes. Shoqëria civile mjedisore në Shqipëri vëren me shqetësim ndikimin në rritje të përqendrimit të ndotësve në ajër-ujë-tokë, me pasoja të drejtpërdrejta mbi shëndetin dhe sigurinë e komuniteteve të ndryshme, mbi ekonominë dhe mjedisin në përgjithësi.

Ndotja sot është një sfidë globale dhe karakteristike e ekonomive apo vendeve në zhvillim, të cilat u japin prioritet aktiviteteve me përfitim të lartë ekonomik, por në kurriz të shfrytëzimit të resurseve apo mjedisit në tërësi për shkarkimin e eksternaliteteve. Rrjedhimisht kjo disbalancë ka shkaktuar probleme me qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në terma afat-mesëm dhe afat-gjatë.

Ndotja e kombinuar me ndryshimet klimatike janë një realitet global. Ky i fundit paraqitet si kërcënim i shtuar ndaj vendeve të vogla si Shqipëria, ku vihet re një rritje e frekuencës së ngjarjeve ekstreme të motit si përmbytjet, thatësira e tejzgatur, valët e të nxehtit dhe zjarret në pyje, etj. Rreth 55% e popullsisë së vendit tonë¹, kryesisht e përqendruar në Ultësirën Perëndimore, vlerësohet të jetë e ekspozuar ndaj rreziqeve të lidhura me klimën, një shifër më e lartë se vlerësimi global prej 40-45%. Binomi, ndotje dhe ndryshime klimatike, sidomos me tjetërsimin e shërbimeve të ekosistemit dhe rritjen e temperaturës, ka sjellë ndryshime në habitatet natyrore dhe biodiversitetin duke rritur presionin mbi habitatet dhe llojet më të kërcënuara, sidomos ato lagunore dhe bregdetare, dhe shtimin e llojeve aliene dhe invazive². Agresiviteti i këtyre fenomeneve rritet ndjeshëm në zonat urbane duke qene se gjatë dekadave të fundit betonizimi ka sjellë humbjen e hapsirave natyrore duke i izoluar këto hapsira, gjë e cila ka sjellë ekspozimin e qytetarëve në temperatura më të larta, cënimin e higjenes publike nga shkarkimet e ujërave të ndotura dhe pikat e grumbullimit të mbetjeve.

Vlerësojmë si të pa-arsyeshme neglizhencën që institucionet përgjegjëse në Shqipëri, krahas vendeve të tjera në rajon dhe më gjerë, paraqesin për të adresuar këtë sfidë globale. **Mungesa e angazhimeve konkrete për monitorimin, gjurmimin dhe reduktimin e ndotjes në ujë, ajër dhe tokë i ka fillesat e veta prej reformës territoriale deri në minimumin e vet historik në 2022-2023.** Rrjedhimisht mund të arsyetohet se kuadri ligjor i cili rregullon çështjet e ndotjes së ajrit, ujit, tokës si edhe monitorimit dhe inspektimit të ndotjes në vend nuk zbatohet.

Kjo situatë ka gjeneruar në jo pak raste konflikte midis ndotësit dhe komunitetit apo habitatit të ekspozuar, raste që mbeten ende të pa adresuara apo në procese të zgjatura gjyqësore si pasojë e subjektivitetit në mungesë të referencave të akredituara nga autoritetet përkatëse. Nisur nga kjo panoramë, organizatat mjedisore në vend vlerësojnë se **Shqipëria po vonon në këtë mënyrë edhe zbatimin e projeksioneve të ratifikuara nga Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor** në raport me 2 prioritetet kryesore të Deklaratës së Sofjes: a) Reduktimi Ndotjes; b) Dekarbonizim, duke ulur shkarkimet e gazeve serë me 20.9% deri në vitin 2030 dhe u renditur renditur krahas vendeve që synojnë të jenë me shkarkime zero në vitin 2050.

¹ INSTAT (2023) Te dhena kyce per popullesine <https://www.instat.gov.al/statistika>

² Government of Albania (2021): Albania revised NDC faqe 50 (<https://unfccc.int/sites/default/files/2022-08/Albania%20Revised%20NDC.pdf>)

Pavarësisht përpjekjeve dhe asaj çka në dukje është një kuadër ligjor i përafuar me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, neglizhenca për adresimin institucional të çështjeve të ndotjes nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Institutit të Shëndetit Publik, Inspektoriatit dhe Drejtorive Rajonale Mjedisore si edhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka ndikuar në krijimin e një klime të padrejtë për komunitetet të cilat ekspozohen ndaj ndotjes dhe një klimë favorizuese për ndotësit të cilët në mungesë të monitorimeve lirisht kontribuojnë në përkeqësimin e situatës së ndotjes. Këtu tërheqim vëmendjen se **vet-monitorimi në mungesë të inspektimeve dhe monitorimeve publike është tërësisht subjektiv dhe favorizues.**

Në këndvështrimin e detyrimeve që lindin prej procesit të integritimit evropian, shohim me shqetësim progresin e ngadalshëm, fillimisht në zbatimin e ligjeve ekzistuese qoftë nga autoritetet përgjegjëse qendrore por edhe më tepër nga ato lokale të cilat nuk përmbushin as detyrimet më minimale. E gjithë kjo situatë kundrejt dinamizmit dhe zhvillimeve të vrullshme për qasje miqësore ndaj mjedisit nga nivelet më të larta politik-bërëse.

Janë të panumërt artikujt shkencorë³ të cilët referojnë lidhjen e drejtpërdrejtë të impaktit në shëndet që ka ekspozimi ndaj grimcave PM dhe NO₂ sikundër ka faktuar që tanimë mikroplastika është futur thellë në zinxhirin ushqimor apo ndikimi që ka zhurma në përkeqësimin socio-psikologjik të qytetarëve e pa harruar që të gjitha këto janë kosto që i mbart shëndeti dhe xhepi i qytetarit. Nga ana tjetër, duke sjellë sërish në vëmendje faktin se ndotja është një sfidë globale, Kombet e Bashkuara kanë sanksionuar së fundi Rezolutën A/76/I.7 ku integron në paketën e të drejtave themelore të njeriut sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Ndër të tjera, vëmë re se ndikimi në shëndet dhe socio-ekonomi paraqet sfidë dhe e thëllon më shumë hendekun ekzistues të pabarazisë gjinore në Shqipëri. Kjo pasi shohim që në rastet e ekspozimit dhe ndikimit nga ndotja, cilido qoftë i prekuri, automatikisht rritet ndjeshëm ngarkesa familjare për gratë/vajzat sa i takon lehtësimit të këtyre ndikimeve qoftë brenda bërthamës familjare por edhe dimensioneve më të gjëra socio-ekonomike. Është me rëndësi që politikat dhe programet që zhvillohen në vendin tonë të kenë indikatorë gjinor që të lehtësojnë/adresojnë këto ndikime, të cilat aktualisht as njihen dhe as pranohen si të tilla. Lidhur për sa më sipër, mungesa e të dhënave gjinore në adresimin e problemeve apo edhe kur zbatohet ndërhyrja për dhënien e zgjidhjes për problemet e shfaqura, të ndiqen dhe të vihen në zbatim dokumentet apo politikat ekzistuese shtetërore siç mund të jetë: “Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 – 2030” dhe të planit të saj të veprimit.

Në mungesë të monitorimeve, inspektimeve, gjumrimit të ndotjes apo masave për reduktimin e saj në një kohë kur as nuk dihet më cilat janë zonat e nxehta, organizatat mjedisore në vend kanë marrë përsipër që në mënyrë alternative dhe të bazuar në fakte, të informojnë publikun, median sikundër edhe autoritetet në lidhje me rezultatet që gjenerohen nga praktikat e monitorimit në terren. Në përgjigje të klimës jo-transparente, jo-gjithëpërfshirëse sërish i bëjmë thirrje autoriteteve që të përdorin gjetjet tona sikundër edhe do të gjejnë gatishmërinë tonë për të ndihmuar e kontribuar në zbatimin e parashikimeve ligjore apo ngritjen e kapaciteteve që adresojnë çështjet e ndotjes në vend.

Shoqëria civile dhe ekspertët e mjedisit dhe të ndotjes konstatojnë se:

Ndotja e Tokës

Ndotja e tokës në Shqipëri vjen kryesisht si rezultat i disa faktorëve të lidhur me mënyrën e përdorimit të tokës si dhe praktikave individuale, institucionale e industriale të trajtimit të saj. Menaxhimi i dobët i mbetjeve në nivel vendor, kombinuar me menaxhimin e mbetjeve industriale

³ Schraufnagel DE, Balmes JR, Cowl CT, et al. Air Pollution and Noncommunicable Diseases: A Review by the Forum of International Respiratory Societies' Environmental Committee, Part 1: The Damaging Effects of Air Pollution. Chest 2019; 155:409-416.

dhe menaxhimin e zhvillimit të territorit në tërësi kanë krijuar një situatë të vështirë përsa i takon ndotjes së tokës.

Ndotja vjen si rezultat i praktikave të planifikimit të territorit ku nuk tregohet kujdes në vendosjen e kushteve dhe standarteve për funksione të caktuara të cilat ndikojnë në ndotjen e tokës; praktikave të menaxhimit të mbetjeve industriale dhe atyre vendore; mungesën e politikave të qarta për promovimin e përdorimit të "brownfield" dhe pastrimit të tyre, veçanërisht në ish-zona industriale; përdorimi i pesticideve dhe kontaminuesve të tjerë në bujqësi; mos-trajtimi i mbetjeve industriale dhe atyre të rrezikshme, veçanërisht mbetjeve të cilat depozitojnë metale të rënda; sistemet e transportit dhe emetimet e gazrave.

Të dhënat laboratorike të matjeve në tre hotspote të përzgjedhura nga organizata Eco Partners for Sustainable Development, në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë, gjatë periudhës Janar – Prill 2022, tregojnë për përmbajtje të lartë të metaleve të rënda në tokë (Cd, Cu, Pb, Ni etj), duke kaluar disa herë standardet kombëtare dhe ato të BE-së (VKM nr. 246, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore"). Mostrat e tokës kanë përqëndrim të metaleve të rënda (Cd>2ppm, Co>20ppm, Ni>120ppm dhe Pb>100ppm), duke ndikuar në uljen e produktivitetit të tokës dhe kufizuar përdorimin e ujit për nevojat e njerëzve. Fertiliteti aktual i këtyre tokave, ka ardhur gjithmonë e në rënie. Pushteti vendor dhe komuniteti i ndikuar e kanë të nevojshme të informohen për problematikën dhe situatën mjedisore, si një e drejtë mjedisore që buron nga e drejta ndërkombëtare dhe kombëtare për një mjedis të shëndetshëm.

Rasti i kripëzimit të tokave mbetet një nga problemet shqetësuese për sa i përket ndotjes. Fenomeni i kripëzimit ndikon në masën që pjelloria e tokës të ulët, cilësitë fiziko-kimike të përkeqësohen dhe që rrjedhimisht toka të bëhet e pa përshtatshme për kultivim si dhe kufizohet rritja e bimëve dhe zhvillimi i tyre i plotë. Nga një studim i kryer për kripëzimin e tokës bujqësore në zonat bregdetare të vendit (Lushnje- Vlorë), masat për përmirësimin dhe parandalimin e kripëzimit të mëtejshëm⁴, theksohen disa tematika kyçe për sa i përket dinamikave të kripësimit të tokës bujqësore. Bimësia spontane në tokat kripura evidenton zgjerimin e kripëzimit, rikripëzimit dhe rritjes së përmbajtjes së kripërave. Rikripëzimi i serave është një fenomen i konstatuar vite më parë nga studime të hershme, përmes analizave të tokës dhe ujërave që përdoren për ujtitje, ose përmbajtjes së kripërave në ujërat nëntokësore që përdoren për ujtitje, sidomos në kushtet e kullimit jo normal.⁵

Në kontekstin e qeverisjes së tokës bujqësore, reformave dhe çështjeve të cilat duhet të adresohen, është e nevojshme të punohet për rehabilitimin e tokave bujqësore të prekura nga ndotja me metale të rënda në afërsi të objekteve të braktitura të industrisë kimike, metalurgjike dhe minierare, e cila shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 8000-9000 ha. Në këtë kontekst vendi ynë, duhet të forcojë dhe zgjerojë laboratorët në mënyrë që të monitorojë sistematikisht të gjithë treguesit e tokës bujqësore. Institutet dhe institucionet kërkimore shkencore në këtë fushë, janë shkrirë me njëra tjetrën nga VKM me nr 515, datë 19.07.2006 "Për Ristrukturimin e Instituteve Kërkimore-Shkencore, në Varësi të Ministrisë Së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", dhe tashmë kërkimet në këtë fushë janë thuajse inekzistente.⁶

Ndotja e Ujit

Ndotja e ujit në Shqipëri vjen kryesisht si rezultat i shkarkimeve të pakontrolluara individuale, institucionale e industriale të ujërave të ndotura. Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura si edhe

⁴ Kripëzimi i tokës bujqësore në zonën bregdetare Lushnje- Vlorë, masat për përmirësimin dhe parandalimin e kripëzimit të mëtejshëm. Prof. Dr. Sh. Lushaj

⁵ Burimi: Studim në bashkëpunim: publikuar në revistën shkencore "Buletini Shkencave Bujqësore" nr.2, 2003, fq 14-22 (prof Dr. Sh. Lushaj)

⁶ Improving the governance and administration of agricultural land in Albania. Sh. Lushaj

mungesa e kontrollit në territor sa i takon pikave të shkarkimit dhe monitorimit të cilësisë së ujërave ka krijuar një situatë të vështirë për sa i takon ndotjes së ujit.

Konkretisht, të dhënat laboratorike nga organizata Eco Partners for Sustainable Development, tregojnë se ujërat e analizuar kanë përmbajtje të lartë dhe shumë të lartë të metaleve të rënda, si: Zn >2000 µg/l; Ni>20 µg/l; Cr >100 µg/l; Cu>20 µg/l; Co>50 µg/l; Pb> më shumë se norma vjetore 7.2 µg/l. Vlerat e parametrave të pH NKO, NBO5, H2S tregojnë se, nafta ka shkaktuar ndryshime të kushteve të sistemeve ujore, duke ndikuar në vazhdimësinë e biotës në zonën nën presionin e ndotjes. Nga raporti vlerësimit social që organizata ka hartuar, rezulton që ka një mungesë informacioni dhe monitorimi të shëndetit të banorëve që jetojnë në këtë territor, për të vlerësuar se si ndikon situata e mjedisit direkt në cilësinë e shëndetit të tyre.

Një tjetër studim, nga organizata H2H Foundation thekson se ndotja e trupave ujqor që përdoren për ujë, sjell pasoja të rënda në shëndetin e fermerëve të cilët merren me ujitjen e tokave bujqësore si edhe pasoja në shëndetin e konsumatorit fundor, ndotje të tokës si edhe rënie të produktivitetit të kulturave si rrjedhojë e grumbullimit në sasi të konsiderueshme të ndotësve të ndryshëm. Nëpërmjet kryerjes së kampionimeve në tre periudha të ndryshme të përdorimit dhe aksesit ndaj ujit për ujë në kanalin ujëtës Bërzhit-Petrelë-Vaqarr, i cili ndodhet në krah të lumit Erzen, është konkluduar se në kanalin kryesor ujëtës parametrat biologjike si nevoja biokimike për oksigjen, Echeria Coli, Total Coliforms, Intestinal Eterococci, kanë rezultuar mbi normat e lejuar të përcaktuar nga Direktiva Kuadër e Ujit nga Bashkimi Evropian si pasojë e shkarkimeve urbane të pamëshuar në këtë kanal.

Mbetet e paqartë situata me impaktin që këta ndotës qoftë organik apo inorganik kanë në cilësinë e akuiferëve nga ku furnizohet popullata me ujë të pijshëm.

Ndotja e Ajrit

Ndotja e ajrit në Shqipëri vjen kryesisht si rezultat i shkarkimeve të pakontrolluara individuale, institucionale e industriale të komponentëve ndotës në ajër. Mungesa e monitorimit dhe gjurmimit ka shkaktuar edhe reduktim të masave të cilat sanksionohen nga lejet mjedisore të subjekteve private. Rrjedhimisht është konstatuar gjatë periudhës 2018-2022 një rritje e përqendrimit të ndotësve PM me 17% dhe NO₂ me të paktën 33% krahasuar me priudhën 2008-2015 mbuluar me monitorime nga institucionet e AKM dhe ISHP në vend.

Nga monitorimet e kryera së fundmi në qytetin e Tiranës, nga Milieukontakt Shqipëri, në 400 pika monitorimi për parametrat CO₂, NO₂, PM₁₀ dhe PM_{2.5} është vërejtur se vlerat e dala nga matjet e kryera gjatë sezonit të vjeshtës 2022 janë më të larta se normat e vendosura nga BE (dy deri në dhjetë herë më të larta). Faktori kryesor që çon drejt kësaj ndotje është transporti, duke u pasuar më tej nga zhvillimi urban dhe industria e ndërtimit. Qyteti i Tiranës është një vend tepër i ndotur, madje shumë mbi normat e lejuara. Kjo ndotje sjell probleme shëndetësore të banorëve dhe ul ndjeshëm mirëqenien e tyre. Zonat më të ndotura në Tiranë janë Astiri, 21 Dhjetori, rruga e Durrësit dhe Kavajës, Bulevardi Zhan Dark, rruga e Dibrës si dhe shumica e rrugëve kryesore me fluks të madh të qarkullimit të automjeteve ose zona ku ka kantiere ndërtimi.

Cilësia e ajrit në 100 pika të monitoruara, nga organizata Together for Life, në rrugët dhe kryqëzimet kryesore urbane të Durrësit është mbi normën e lejuar, ku niveli i ndotjes nga të 4 ndotësit e matur (NO₂, CO₂, PM_{2.5}, PM₁₀) ka një rritje të dukshme. Ndotësi kryesorë gjatë sezonit të verës në Bashkinë Durrës është NO₂, i cili vjen kryesisht si pasojë e trafikut të rënduar të automjeteve në rrugët dhe kryqëzimet kryesore. Tejkallim me dy herë të normave të lejuara të dioksidit të azotit janë evidentuar në kryqëzime që lidhin rrugët e brendshme të qytetit dhe janë akse kryesore për lëvizjen e qytetarëve. Sektori i transportit është kontributori më i madh, për sa i përket shkarkimeve të ndotësve në ajër, gjatë sezonit të verës. Vendi i dytë zihet nga aktivitetet ndërtimore, si kontribuesit kryesor në përqendrimin e lartë të grimcave në ajër.

Në qytetin e Elbasanit, nga 150 pika të monitoruara 1/3 e tyre ka rezultuar me vlera deri në tre herë më të larta të NO₂, ndërsa vlerat e CO₂ janë pak më të larta se standarti Evropian. Grimcat e Pluhrit janë brenda normave në përgjithësi por në kryqëzimet kryesore këto parametra janë shumë herë më të larta. Zonat ku kanë rezultuar vlera maksimale janë në pjesën jugore të qytetit, unaza jugore dhe qendra e qytetit. Këto vlera vijnë si pasojë e trafikut të rënduar dhe lëvizjes së dendur të automjeteve, sidomos në orët e pasdites ku edhe aktiviteti i automjeteve është më i lartë.

Nga monitorimet e kryera në 150 stacione në Korçë, nga Qendra EPER, problematike kanë rezultuar dhe mbeten gazrat që çlirohen nga djegia e druve të zjarrit për ngrohje në sezonin e dimrit (CO₂, grimcat e pluhurit PM_{2.5}, etj). Po ashtu edhe cilësia e karburanteve dhe e automjeteve ndikon në cilësinë e ajrit në bashki. Nga monitorimi i realizuar dallohet se në të dy sezonet vlera mesatare e NO₂ është jashtë normave të lejuara të BE duke kapur vlerën maksimale 110 µg/m³. Ndërsa në dimër CO₂ dhe grimcat e pluhurave janë mbi normën e BE me një mesatare prej 650ppm.

Monitorimi i ajrit në 200 stacione në qytetin e Shkodrës, nga organizata GO2, tregon vlera shqetësuese gjatë verës për parametrat e CO₂ dhe NO₂. Dioksidi i Karbonit shfaqet shqetësues në 177 stacione ose 88.7% të zonës urbane. Ndërkohë, NO₂ shfaqet mbi normën e lejuar në 109 stacione (54.5%). Më pak shqetësuese janë grimcat PM₁₀ dhe PM_{2.5}, të cilat i tejkalojnë standardet në mbi 14.5% - 19% të numrit total të stacioneve të monitorimit. Rezultatet e monitorimeve në Mars 2023 tregojnë se CO₂ shfaqet ndër parametrat më problematik në 60% të stacioneve, NO₂ shfaqet mbi normë në 40% të rasteve, PM₁₀ është mbi normë në 7.5% dhe PM_{2.5} në 11.5% të rasteve.

Nga konstatimet e mësipërme, vlerësojmë se duhen marrë masa të rrepta dhe të shpejta për të minimizuar sa më shumë ndotjen, në mënyrë që t'i afrohem standartit Evropian. Ndërsa rrisim urbanizimin dhe dendësinë e qyteteve tona, duhet të planifikohet dhe të përdoren masat e duhura zbutëse për të siguruar një cilësi të mirë jetese për banorët.

Për të adresuar këto problematika:

- 1. Burimet financiare të dedikuara për të adresuar çështjet e ndotjes dhe pasojat e saj janë të pamjaftueshme** dhe nuk garantojnë arritjen e objektivave të sanksionuar në ligj dhe në planin kombëtar për cilësinë e ajrit. Vërejmë me shqetësim se vlerësimi i efektivitetit të përdorimit të burimeve financiare të buxhetit të shtetit apo fondeve të huaja është pothuajse i paidentifikueshëm për shkak të pamundësisë së gjurmueshmërisë së fondeve të dedikuara për ndotjen në sistemin e llogarive të vendit. Marrim shkas nga taksa 3 lek/lit që aplikohet në pompat e naftës, njohur si taksa e karbonit. Vlerësohet që nga zbatimi saj deri më sot janë gjeneruar mbi 125 mln Euro nga të cilat nuk shohim që të ketë përmirësime në asnjë aspekt të lidhur me monitorimin apo uljen e ndotjes nga ky sektor.
- 2. Burimet njerëzore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe agjencive mbeten tepër të kufizuara dhe pakualifikuara.** Problematika është edhe më e mprehtë në nivelin vendor ku kërkohet avancimi lidhur me plane të ndryshme vendore që do të adresojnë çështjet e ndotjes, energjisë, klimës etj. Ky aspekt është referuar në mënyrë të përsëritur për disa vite radhazi edhe në raportet e Komisionit Evropian për vendin tonë.
- 3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencitë nën varësinë e saj nuk e zbatojnë kuadrin ligjor në fuqi, sa i takon monitorimit, gjurmimit dhe penalizimit ndaj shkeljeve lidhur me shkarkimet ndotëse në mjedis.** Ne, përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile, kërkojmë nga institucionet përgjegjëse politik-bërëse dhe ligj-zbatuese që të vlerësohet me seriozitetin më të lartë ndotja me të cilën përballet vendi dhe komunitete të ndryshme në Shqipëri. Kjo nevojë për trajtim të shpejtë, të integruar dhe koherent me politikat evropiane bëhet më e shprehur prej pamundësisë së vendit tonë për t'u përballuar me këto pasoja për shkak të neglizhencës ndaj monitorimit dhe gjurmimit sikundër dhe kufizimeve që kanë institucionet dhe ekonomia e vendit tonë.

4. **Rritjen e përfshirjes së publikut në diskutimin për çështjet ndotjes** dhe adresimin e problematikave të lidhura me pasojat shëndetësore e sociale të ndotjes duke vlerësuar me përparësi nevojat e shtresave më të varfra dhe të cenuara të popullsisë që përballen me këto pasoja;
5. **Rritjen e transparencës lidhur me fondet dhe investimet e dedikuara apo që ndikojnë mbi ndotjen**, sidomos në sektorët kyç të ekonomisë, si ato të transportit, industrisë, energjisë, bujqësisë, dhe menaxhimit të mbetjeve.
6. **Mbështetjen për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale për adresimin e çështjeve të lidhura me ndotjen në institucionet përgjegjëse**, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqërinë civile.
7. **Vënia në funksion të plotë të sistemeve të kullimit të tokave**, në përputhje me ligjin për ujat dhe kullimin. Hartimi i strategjive afat mesme dhe afat gjata për të ndaluar rikripëzimin e mëtejshëm të tokave në zonën bregdetare (afatmesëm) dhe të shkripëzimit të tokave me nivel të lartë kripëzimi (afatgjatë).

Për Institucionet Qendrore dhe Vendore:

- Të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi duke siguruar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve për të garantuar përmbushjen “E drejta për jetën” dhe “E drejta për të patur një mjedis të shëndetshëm”, e sanksionuar në Konferencën e Stokholmit (1972), si e drejtë themelore e njeriut, si dhe është e drejtë kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.
- Struktura inspektuese e mjedisit, në varësi të AKM-së, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 63, gërmat “b” dhe “d” të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, përkatësisht të kryejnë: (i) monitorimin e ndikimit të veprimtarive mbi mjedisin për të përcaktuar nëse kërkohen veprime të mëtejshme, duke përfshirë shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit, për të siguruar përputhjen me legjislacionin përkatës; (ii) verifikimin dhe vlerësimin e monitorimit të përputhjes së bërë nga operatori i veprimtarisë;
- Të përmirësohet sistemi i monitorimit mjedisor nga organet kompetente të pushtetit qendror, si dhe lokal i këtyre territoreve të ndikuara nga shfrytëzimi i industrisë nxjerrëse nëpërmjet amendimit të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”.
- Të jetë publike harta e ndotjes së ajrit, tokës dhe ujit për të informuar komunitetin dhe kompanitë, si dhe ndihmuar planet vendore të menaxhimit të territorit dhe të ngrihet dhe funksionojë sistemi i informimit mjedisor për zonat hot-spot;
- Bashkitë përkatëse kanë të drejtë jo vetëm të informohen nga subjektet, por dhe të jetë palë e procesit të vlerësimit mjedisor, ashtu sikurse përcaktohet edhe në legjislacionin në fuqi. Konventa e Aarhusit që është përparësore edhe ndaj ligjeve shqiptare të mjedisit, përfshin të drejtën e aksesit në informacion, të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe të drejtën e aksesit në mjete juridike.

Si përfaqësues të shoqërisë civile jemi të ndërgjegjshëm për kontributin që duhet të japim, krahas të gjithë aktorëve të tjerë të shoqërisë shqiptare, ndaj shprehemi të gatshëm për të qenë pjesë aktive e diskutimit dhe veprimit ndaj ndotjes.

Tiranë, 20 Prill 2023

Forumi Kombëtar i Ndotjes



Aneks 2 – Agjenda



FORUMI KOMBËTAR I NDOTJES

Ndotja në Shqipëri është një nga çështjet me ndjeshmëri të lartë pasi që presioni për zhvillim në shumë raste nuk është shoqëruar me masat përkatëse për të reduktuar impaktin e zhvillimit mbi mjedis dhe shëndetin publik. Në kushtet kur kapacitetet gjurmuese të ndotjes në vënd janë thuajse inekzistente, politikat për mbrotjen e cilësisë së ajrit, ujit, tokës, nuk gjenë zbatim dhe për më tepër kanë gjeneruar konflikt. Lidhja mes ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe shëndetit publik janë të mirëpranuara publikisht nga shkenca, autoritetet dhe së fundi janë sanksionuar nga Kombet e Bashkuara nëpërmjet Rezolutës A/76/l.7 si e drejte themelore e njeriut për të jetuar në mjedis të shëndetshëm.

Milieukontakt Shqipëri, Qendra EPER, Together for Life dhe GO2, kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në Forumin Kombëtar "Ndotja e Mjedisit", datë **20 Prill 2023, ora: 09:00** në ambientet e Hotel Tirana International. Ky forum zhvillohet në kuadër të programit **Green_AL** dhe projektit "**Ajër i pastër, jetë e shëndetshme**" i cili financohet nga **Sida**: Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim me fondet e Qeverisë Suedeze, i zbatuar nga *Co-PLAN Instituti per Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me VIS Albania – Volontariato Internazionale per lo Sviluppo*, *COSV - Coordinamento delle Organizzazioni del Servizio Volontario*, *CISP Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli*.

Ju ftojmë që në pëmbushje të misionit që ka shoqëria civile sikundër dhe angazhimi komunitarë të parashtrijmë bashkarisht, gjëndjen e ndotjes në AJËR, UJRA dhe TOKË sikundër edhe të kërkojmë publikisht fundin e neglizhencës së qëllimshme të gjurmimit, parandalimit dhe menaxhimit të ndotjes në Republikën e Shqipërisë.

Në emër të Co-PLAN dhe Milieukontakt do të vlerësonim praninë tuaj në këtë takim si vlerë e shtuar e këtij forumi kombëtar!

Ju lutem të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj brenda datës 18 Prill 2023, ora 11:00 tek adresa: office@milieukontakt.org.

Në vijim gjendet programi i forumit:

KOHA	TEMATIKA	FOLËS
09:00 – 09:30	Regjistrimi i pjesëmarrësve	
09:30 - 09:45	Hapja zyrtare e forumit dhe përshëndetjet	Znj. Valbona Mazreku Drejtore Ekzekutive, Milieukontakt Shqipëri Shkëlqesia e saj Znj. Elsa Hastad Ambasadore, Ambasada e Suedisë në Shqipëri
09:45 – 11:15	<p align="center">SESIONI I: Këndvështrimi i OSHC-ve Mjedisore mbi Ndotjen në Shqipëri</p> <p>AJËR</p> <p>UJI</p> <p>TOKA</p>	<p>Z. Rodion Gjoka, Themelues i platformës Green Lungs Znj. Albana Joxhe, Milieukontakt Z. Elvis Cela, Qendra EPER</p> <p>Z. Erjon Kalaja H2H: Active Water Znj.Ornela Shoshi Z. Edi Truka North Green Association: Erzeni Thëret</p> <p>Z.Ledio Allkja Ekspert i Planifikimit dhe Qeverisjes së Territorit Znj.Aurora Dibra Akademike Znj. Entela Pinguli, Eco Partners</p>
11:15 – 11:30	PUSHIM KAFE / Seancë paralele Intervistash	
11:30 – 12:30	<p align="center">SESIONI II: Këndvështrimi Donatorëve dhe Institucioneve mbi Ndotjen në Shqipëri.</p> <p>EUD Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri</p> <p>GIZ Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</p> <p>OSCE Organization for Security and Co-operation in Europe</p> <p>SANE27 – Sida Supporting Albanian Negotiations in Environment</p> <p>MTM Ministria Turizmit dhe Mjedisit</p> <p>KLSH</p>	<p>Z. Andrea Vera, Drejtues për Zhvillimin e Qëndrueshëm Z.Philipp Steinheim Menaxher i Programit për Ndotjen Detare</p> <p>Z.Elton Qendro Koordinator Kombetar</p> <p>Z.Jadranka Ivanova Drejtuese Programit</p> <p>Znj.Klodiana Marika</p>

	Kontrolli i Larte i Shtetit	Drejtoreshë
	ISHP tbc	Z.Besnik Bare Keshilltar prane Kryetarit
12:30 – 13:15	SESIONI III: Këndvështrimi dhe Kontributi Medias mbi Ndotjen në Shqipëri.	
	Citizens Channel	Z.Lorin Kadiu
	SCAN TV	Znj.Ola Mitre
	BIRN	tbd
	STOP	Znj. Odeta Gjevori
	Freelance Journalist	Z. Artan Rama
13:15 – 14:00	Diskutime mbi Deklaraten e përbashkët të Shqoqërisë Civile në raport me ndotjen	
14:00 ____	Buffe	

Moderator: Sokol Haxhiu

Gjuha: Shqip/Anglisht

Aneks 3 – Organizatat nënshkruese të deklaratës

Nr	Emri i organizatës
1.	Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Albania)
2.	Forumi i Mendimit të Lirë (FML)
3.	Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit
4.	COSV Albania - Cooperazione per lo Sviluppo
5.	VIS Albania - Volontariato Internazionale per lo Sviluppo
6.	CISP Albania - Sviluppo dei Popoli
7.	Universiteti Polis
8.	Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)
9.	Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit (ETMI)
10.	Instituti i Politikave Mjedisore (IEP-IPM)
11.	Agri-En Librazhd
12.	Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)
13.	Edukimi Komunitar për të Drejtat, Kulturë, Integrim (CERCI)
14.	ECO-Partners for Sustainable Development
15.	Ekologët për Rajonin, Kukës
16.	Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER Center)
17.	Federata për Perdorimin e Pyjeve dhe Kullotave, Kukës
18.	Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri
19.	Milieukontakt
20.	Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit (MMZHT)
21.	New Bridge
22.	North Green Association
23.	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)
24.	Qendra Sociale në Ndhmë të Njerëzve në Nevojë (QSNN)
25.	Rur.al
26.	Shoqata "Unë, Gruaja"
27.	Shoqata "Agro Puka"
28.	Shoqata "Alpin", Tropojë
29.	Shoqata "Miqesia Ulez", Mat
30.	Shoqata Delfini, Qarku Dibër
31.	Social Development Investment, Tirane (SDI-AI)
32.	Well Point, Kujdes për të gjithë
33.	Vizion i Gjelbërt
34.	Edukimi Social për mbrojtjen e mjedisit (SEEP)
35.	New Impact
36.	Forumi Shqiptar i Liqenit të Shkodrës (FSLS)
37.	Shoqata Blini
38.	Shoqata "MENVgroup"
39.	Nisma e Luleve
40.	GO2

41.	Together for life (TFL)
42.	Flag Pine
43.	Federata e Pyjeve Shkoder
44.	Qendra All Minds Empowerd
45.	Mary ward Loreto
46.	Qendra e Keshillimit te Grave dhe Sherbimeve Sociale
